

**AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
BLUE TDI SH.P.K.**

Sot më datë 25.07.2019, palët e mëposhtme:

- **Shoqëria WSI Sh.p.k**, një shoqëri e së drejtës shqiptare, e pajisur me NUIS L32301006L dhe me seli në adresën: Rruga Pjetër Bogdani, Pallati 39/1, Ap.4/4, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga administratori, Znj. Vanessa Sinani;
- **Shoqëria Blessed Investment Sh.p.k**, një shoqëri e së drejtës shqiptare, e pajisur me NUIS L71423028S dhe me seli në adresën: Rruga Themistokli Gërmenji, kati I, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga administratori, Znj. Ana Lleshi;
- **Shoqëria Matrix Konstruksion Sh.p.k**, një shoqëri e së drejtës shqiptare, e pajisur me NUIS J91306009Q dhe me seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga "Nikolla Jorga", Godina Nr.18/2 Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga administratori, Znj. Ida Mezin.

në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", i ndryshuar, dhe legjislacionin shqiptar, nëpërmjet nënshkrimit të këtij Akti Themelimi kanë vendosur të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emëruar **Blue TDI Sh.p.k**. Aktiviteti i kësaj shoqërie do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj bashkalidhur këtij akti si Shtojca A, i cili konsiderohet pjesë thelbësore e Aktit të Themelimit.

**Neni 1 – Emërtimi i Shoqërisë**

- 1.1 Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur **Blue TDI Sh.p.k** (këtej e tutje referuar edhe si "Shoqëria").
- 1.2 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

**Neni 2 - Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga "Nikolla Jorga", Godina Nr.18/2 Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Shoqëria mund të hapë dhe/apo mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, në Shqipëri apo jashtë saj.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

- 3.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.
- 3.2 Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, me një shumicë të thjeshtë prej 51%.

**Neni 4 – Objekti i Aktivitetit**

- 4.1 Shoqëria do të ketë për objekt kryesor aktiviteti investimet e ndryshme direkte ose indirekte në fushën e turizimit, ndërtim dhe/ose zhvillim i objekteve të ndryshme në fushën e turizimit dhe të hotelerisë, menaxhimin dhe organizimin e aktiviteteve shoqëruese dhe zhvilluese të turizimit/hotelerisë, shërbimeve të akomodimit, logjistikës dhe çdo aktivitet që lidhet me to.
- 4.2 Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria do të mund të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm që lidhet me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, dhënie / marrje me qira ose vënien e hipotekave që mund të konsiderohet e dobishme ose e domosdoshme për realizimin e qëllimeve të Shoqërisë, si dhe çdo aktivitet tjetër që direkt apo indirekt lidhet me objektin e aktivitetit të sipërpërmendur siç mund të konsiderohet e domosdoshme ose e dobishme ose ndihmëse në përmbushjen e qëllimeve të mësipërme sipas diskrecionit të vetë Shoqërisë.

## Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 Lek (një qind Lek), i përbërë nga 3 (tre) kuota. Kapitali themeltar i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar plotësisht si në vijim:
- Shoqëria WSI Sh.p.k ka kontribuar në para në kapitalin e Shoqërisë në shumën prej 55 (pesëdhjetë e pesë) Lekë;
  - Shoqëria Blessed Investment Sh.p.k ka kontribuar në para në kapitalin e Shoqërisë në shumën prej 22.5 (njëzet e dy presje pesë) Lekë;
  - Shoqëria Matrix Konstruksion Sh.p.k ka kontribuar në para në kapitalin e Shoqërisë në shumën prej 22.5 (njëzet e dy presje pesë) Lekë.
- 5.2 Duke u bazuar në kontributet e mësipërme:
- Shoqëria WSI Sh.p.k zotëron 1 (një) kuotë, e barabartë me 55% (pesëdhjetë e pesë për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
  - Shoqëria Blessed Investment Sh.p.k zotëron 1 (një) kuotë, e barabartë me 22.5% (njëzet e dy presje pesë për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
  - Shoqëria Matrix Konstruksion Sh.p.k zotëron 1 (një) kuotë, e barabartë me 22.5% (njëzet e dy presje pesë për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

## Neni 6 – Transferimi i Kuotave

Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 8 të Statutit.

## Neni 7 – Administratori/ët

- 7.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) ose më shumë administratorë, të cilët mund të jenë edhe jo ortak, të emëruar, për një afat prej 5 (pesë) vitesh, nga Asambleja e Përgjithshme. Në përfundim të këtij afati, Administratorët mund të rizgjidhen ose të shkarkohen.
- 7.2 Administratorët përfaqësojnë Shoqërinë ndaj palëve të treta. Administratori ushtron të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme. Statuti mund të parashikojë kufizime në kompetencat e Administratorit/Administratoreve.
- 7.3 Administratori mund të emërojë përfaqësues me prokurë speciale ("ad negotia") për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre.
- 7.4 Personi i mëposhtëm caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë për një afat prej 5 (pesë) vitesh:
- Zj. Ana Lleshi shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 07.05.1981, pajisur me letërnjoftim nr. BB1827505 dhe nr. personal I15507055G, me banim në Tiranë, Shqipëri.

## Neni 8 – Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe bashkëlidhur tij është dhe Statuti i Shoqërisë si pjesë e pandarë.



#### Neni 9 – Dispozita të Fundit

Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare.


Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e këtij akti themelimi dhe të statutit të shoqërisë, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

\*\*\*

NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, Palët deklaroi se ky Akti Themelimi dhe Statuti bashkangjitur si Shtojca A, është në përputhje me vullnetin e tyre dhe për këtë arsye e nënshkruan atë në datën e sipërshtënuar, me vullnet të plotë dhe të lirë, dhe unë Noterja, vërtetoj nënshkrimin e tij sipas ligjit.

#### ORTAKËT

  
Ana Lieshi  
Blessed Investment Sh.p.k.  


  
Ida Mezini  
Matrix Konstruksion Sh.p.k.  


  
VANESSA SINANI  
Vanessa Sinani  
WSI Sh.p.k.

